



e Rahovecit

Mbahet Festivali i Vjeljes së Rrushit në Rahovec



Ky festival (Hardhfest) ka shërbyer në promovimin e produkteve të tyre të rrushit, të verës e të rakisë së njohur rahoveciane, anembanë vendit e edhe jashtë tij. Është hapur edhe panairi i verërave dhe i prodhimeve vreshtare. Hardhfest-in e kanë përcjellë edhe aktivitete të shumta treditore



Përurohet objekti i ri i AMF-së

Në lagjen III në Rahovec, përurohet objekti i AMF-së. Në këtë objekt bashkëkohor, do të ofrohen shërbime parësore shëndetësore për qytetarët e kësaj lagjeje. Ky projekt është financuar nga buxheti i komunës dhe vlera e tij është: **252.269.86 €**.



Kryetari Latifi, bashkë me znj. Caroline Schneider, Zyra e Koordinatorit të OKB-së për Zhvillim, z. Laurent Torche, zëvendës drejtues për Bashkëpunim, Zyra e Zvicrës për Bashkëpunim në Kosovë, përfaqësues nga AME-ja, z. Shefki Abdullahu dhe Kastriot Lajqi, z. Naser Krasniqi, udhëheqës vendor i Organizatës FAO, mbajtën ceremoninë e **shpërndarjes së kuponëve të parë për fermerë.**

Me anë të këtyre kuponëve, do t'u mundësohet fermerëve të blejnë inpute të domosdoshme për fermat e tyre, si: farë, pleh, vegla pune, aparate ujitjeje, pjesë rezervë dhe mallra të tjera të domosdoshme sipas nevojave të tyre.



Në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Rahovecit, miratohet buxheti për vitin fiskal 2024

Pas konsultimeve me qytetarë, biznese, shoqërinë civile, fermerë, gjithashtu, pas dëgjimeve publike buxhetore e vlerësimeve nga profesionistë të të gjitha fushave, sot në mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal të Rahovecit, u miratua buxheti për vitin 2024, i cili në total (për të gjitha kategoritë buxhetore) është: 19,804,785.00 €.



Përrurohet ndrçimi publik me drita digjitale SMART (ESCO)

Në Celinë dhe në Zatriq, përrurohet ndrçimi publik me drita digjitale SMART (ESCO). Celina tashmë ka në funksion, gjithsej: 291 drita, në gjatësi prej 9.7 km.

Zatriqi ka gjithsej: 51 drita, në gjatësi prej 1.5 km.



Ndërtohet kanalizimi në rrugën “Vëllezërit Frashëri” në Rahovec



Gjatësia e këtij segmenti të kanalizimit është 270 m, në të cilin do të lidhen 50 shtëpi të kësaj lagjeje.